

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Maran ndez debutimin: Më emocionon Shqipëria, më bën krenar, duhet të jemi të vendosur për rezultatin
ADRESA	https://top-channel.tv/2026/09/25/maran-para-debutimit-zyrtar-trajneri-flet-per-shqiperi-bjellorusi/
BURIMI	top-channel.tv
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 13:17:45 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	25 shtator 2026, 13:14:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 25 shtator 2026, 13:13:00 UTC → 25 shtator 2026, 13:15:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund t ë gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	05ea21ccea57f419e6d05602104cb25d63e41e98987778820a8ab2632f12dd1c
TEKSTI	16d795e416fe1ff33af6390b4706b41e2a8278a9132b248ba86d2539d9e94d05
PAMJA	4419bb30cab9317875eda358657f0e555968fdc52c020203c8828cff3a103896

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	61d8508f99578a321a688c9fa275f25ff3b971b45cc82a275630cce898d7f799
E MËPARSHMJA	2de3c9344a1bdfc212a3e35bad698994e6a9d4f8efeca6ba8e00dbcf0ffff14b
RRËNJA MERKLE	3a6c0ee943067392b175e06ac07a7b9996bbd474953cea4f063ab0e5555023da
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/61d8508f99578a321a688c9fa275f25ff3b971b45cc82a275630cce898d7f799>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

FUTBOLL KOMBËTARJA SPORT TË FUNDIT

Maran ndez debutimin: Më emocionon Shqipëria, më bën krenar, duhet të jemi të vendosur për rezultatin

25/09/2026 15:14



Nesër nis zyrtarisht aventura e Rolando Maran në stolin e Kombëtares shqiptare. Përballë do të jetë Bjellorusia, një kundërshtar që vjen pas një serie prej gjashtë ndeshjesh radhazi me rezultate pozitive, por trajneri italian kërkon që kjo të shërbejë vetëm si një motivim shtesë për skuadrën kuqezi.

Në konferencën për shtyp në prag të sfidës, Maran foli për përgatitjet, gjendjen fizike të lojtarëve, alternativat që ka provuar gjatë javës dhe mënyrën se si e sheh debutimin e tij zyrtar.

“Bjellorusia është një skuadër kompakte dhe po ecën shumë mirë. Kemi shumë respekt për ta. Përtej kësaj, unë jam mësuar të përgatis dhe të përqendrohem te skuadra ime. Kemi punuar shumë mirë, sepse kemi gjetur menjëherë stimujt e duhur. Kjo është gjëja më e rëndësishme për mua”, u shpreh Maran.

Trajneri italian nuk e fshehu emocionin për ndeshjen e parë zyrtare në drejtimin e Shqipërisë, ndërsa pranoi se disa lojtarë kanë pasur probleme fizike.

“Është e vërtetë që nesër fillon aventura ime si trajner i Shqipërisë dhe kjo më emocionon dhe më bën krenar. Të bën të japësh edhe më shumë se në kushte normale. Kemi pasur disa probleme fizike me disa lojtarë, por, përpos kësaj, kushdo që do të futet në fushë do të japë maksimumin. Unë kam shumë besim”, tha ai.

Një prej pikëpyetjeve lidhet me gjendjen e Kristjan Asllanit dhe Amir Shehut. Maran konfirmoi se të dy do të stërviten normalisht, ndërsa la të hapur mundësinë që disa prej lojtarëve të mos jenë në gjendje për të përballuar të gjitha 90 minutat.

“Megjë disa lojtarë nuk ishin në kushte optimale, kam provuar shumë alternativa. Asllani dhe Shehu sot do të stërviten normalisht. Kemi provuar shumë alternativa dhe kemi punuar shumë. Ishte një javë impenjative, kështu e kërkoja unë dhe ata m’u përgjigjën shumë mirë. Jam optimist se të gjithë do të rikuperojnë, ndoshta jo për 90 minuta, por do t’i kemi si alternativa”, u shpreh Maran.

Pas disa muajsh në kontakt me lojtarët e Kombëtares, trajneri italian thotë se tashmë e njeh shumë më mirë grupin dhe karakteristikat e futbollistëve. Megjithatë, ai theksoi se forma e lojtarëve ndryshon dhe se zgjedhjet janë bërë duke u bazuar te gjendja e tyre aktuale.

“Sigurisht, tani i njoh shumë mirë. Kam fatin që, përveç grumbullimit, gjatë këtyre muajve jam takuar dhe kam pasur kontakte me ta. Tani situata është ndryshe nga fillimi. Mund të them se tashmë i njoh më mirë karakteristikat e secilit, të cilat nuk i dija më parë. Por duhet të dini se lojtarët ndryshojnë, ka lojtarë që kalojnë momente të

SPORT • KRYESORE



Gjimshiti para Shqipëri-Bjellorusi: Synojmë të shkojmë për herë të tretë në European



Ish futbollisti i Zvicrës i del në krah Xhakës: Duhet të vazhdojë të mbajë shiritin e kapitenit nëse...



‘FIFA duhet të reformohet për të mirën e futbollit’/ Ligat e mëdha evropiane kërkojnë ndryshime në qeverinë e futbollit botëror



Kuqezinjtë nisin misionin e ri në Nations League, të gjitha emocionet live dhe ekskluzivisht në DigitAlb

ME TË LEXUARAT

“Me Yamal s’do të jetoja kurrë”/ Intervista pa filtra e Fermin: Messi më i miri, Lamine më mendjemadhi

Kombëtarja humb edhe një mbrojtës gjatë grumbullimit, zbulohet gjendja e Asllanit. Maran bën manovrat e fundit para Bjellorusisë

Fjeta milioner dhe u zgjova i rrënuar! Roberto Carlos trondit botën e futbollit: Humba 99% të pasurisë brenda një nate

Ronaldo dështon në Lisbonë, shoku i tii të Al Nacer hahet harni i

ndryshme, si për mirë, ashtu edhe jo për mirë. Nuk mund të përmend emra të veçantë. Unë kam grumbulluar ata që ishin në gjendje më optimale dhe më të përshtatshëm për zgjedhjet e mia. Kam punuar shumë për këtë, ju siguroj”, deklaroi Maran.

Përballë do të jetë një Bjellorusi që ka krijuar një seri të mirë rezultatesh, por Maran kërkon që kjo të mos ndryshojë qasjen e Shqipërisë ndaj sfidës.

“Bjellorusia vjen nga një periudhë shumë e mirë, me gjashtë ndeshje radhazi me rezultate pozitive, por kjo për ne duhet të jetë thjesht një stimul. Ne e respektojmë, por duhet të jemi më të vendosur për rezultatin tonë”, theksoi trajneri kuqez.

Maran paralajmëroi gjithashtu se gjatë ndeshjes mund të ketë situata të ndryshme dhe se skuadra duhet të jetë e përgatitur për të reaguar ndaj tyre.

“Gjatë ndeshjes, sigurisht që ka momente dhe alternativa të ndryshme për të ndërhyrë. Ne kemi punuar për të qenë gati në shumë plane. Një ndeshje nuk fillon dhe mbaron asnjëherë njësoj dhe ne jemi të përgatitur për këtë”, përfundoi Maran.

Tashmë fjala është te fusha. Shqipëria dhe Bjellorusia përballen nesër në “Air Albania”, në ndeshjen që shënon edhe debutimin zyrtar të Rolando Maran në stolin kuqez.

Top Channel

I Futboll »



Gjimshiti para Shqipëri-Bjellorusi: Synojmë të shkojmë për herë të tretë në European

25/09 15:07



Ronaldo me zemër të artë, bllokoj pagën e tij për të shlyer detyrimet e klubit ndaj shokëve të tij të skuadrës

25/09 13:47



Kombëtarja U19/ Dy ndeshje miqësore ndaj Lituanisë, trajneri Tafaj grumbullon 22 futbollistë

25/09 13:37



Ish futbollisti i Zvicrës i del në krah Xhakës: Duhet të vazhdojë të mbajë shiritin e kapitenit nëse...

25/09 13:25



‘FIFA duhet të reformohet për të mirën e futbollit’/ Ligat e mëdha evropiane kërkojnë ndryshime në qeverinë e futbollit botëror

25/09 12:31



Italia, Mancini sfidon tabunë rikthim/ Në futboll jo gjithmonë funksionon ulja në të njëjtën pankinë për herë të dytë.

25/09 11:14

I Kombëtarja »



Gjimshiti para Shqipëri-Bjellorusi: Synojmë të shkojmë për herë të tretë në European

25/09 15:07



Kombëtarja U19/ Dy ndeshje miqësore ndaj Lituanisë, trajneri Tafaj grumbullon 22 futbollistë

25/09 13:37



Kuqezinjtë nisin misionin e ri në Nations League, të gjitha emocionet live dhe ekskluzivisht në DigitAlb

25/09 10:27



Kombëtarja humb edhe një mbrojtës gjatë grumbullimit, zbulohet gjendja e Asllanit. Maran bën manovrat e fundit para Bjellorusisë



Si ndryshojnë planet ndaj Bjellorusisë? Asllani e Cake me probleme fizike, Maran kërkon zgjidhje në stërvitje



UEFA Nations League/ Shiten të gjitha biletat e ndeshjes mes San Marinos dhe Kombëtares shqiptare

24/09 18:08

Portugalisë

VIDEO/ Kosova e nis Nations League me këmbë të mbarë, për ‘Dardanët’ vendos Muriqi që ua dedikon golin ish krerëve të UÇK

Nata e dramave në Nations League, Holanda ndal Gjermaninë në shtesë, Haaland “fluturon” me Norvegjinë

Kuqezinjtë nisin misionin e ri në Nations League, të gjitha emocionet live dhe ekskluzivisht në DigitAlb

Izraeli, lojtari shënon dhe simulon guajte bilardoje me flamurin e këndit, arbitri e përjashton(VIDEO)

Ronaldo me zemër të artë, bllokoj pagën e tij për të shlyer detyrimet e klubit ndaj shokëve të tij të skuadrës

Raphinha flet hapur: Dua Champions League, atë gjysmëfinale me Interin nuk e kapërdij dot

25/09 10:01

24/09 19:52

I Sport »



Gjimshiti para Shqipëri-Bjellorusi: Synojmë të shkojmë për herë të tretë në European

25/09 15:07



Botërori i MotoGP/ Prezantohet kalendari 2027, debutojnë Buenos Aires dhe Adelaide

25/09 14:26



Chris Horner jep mesazhin në Maranello: Do të kthehesha në Formula 1 vetëm për Ferrarin

25/09 14:04



Ronaldo me zemër të artë, bllokoi pagën e tij për të shlyer detyrimet e klubit ndaj shokëve të tij të skuadrës

25/09 13:47



Kombëtarja U19/ Dy ndeshje miqësore ndaj Lituaniës, trajneri Tafaj grumbullon 22 futbollistë

25/09 13:37



Ish futbollisti i Zvicrës i del në krah Xhakës: Duhet të vazhdojë të mbajë shiritin e kapitenit nëse...

25/09 13:25

Na ndiqni:



I Video »



Top Channel/ Komenti për fundet e grave, Tajani kërkon falje: Opozita i kërkon dorëheqjen!



Top Channel/ "Kur do vini në Moskë"? Zelensky i kthehet keq gazetarit rus: "Do vij me raketë"!



Top News – Një NATO e botës myslimane... Marrëveshja e Mekës, Turqia bën ftesë për zgjerim



Top News – Shahed, Geran, Gerbera e Orlan... Dronët që Rusia mund t'i nisë nga flota hije në Mesdhe



Top Channel/ Atentati në Sarandë/ TCh siguron videon/ Momenti kur ekzekutohet "Tani i Ruzhdiut"



Top News – 'Prapakthehu' për hemodializën. Anullohet tenderi me vlerë 50 mln euro për 4 vite

Lajme

Lajmet e fundit
Politikë
Kronikë
Aktualitet
Ekonomi
Sociale
Video
Top News LIVE

Bota

Opinion
Koment
Kosova dhe Rajoni
Shkencë dhe Teknologji
Auto

Sport

Kombëtarja
Kategoria Superiore
Kategoria e Parë
Premier League
La Liga
Serie A
Shumësportësh
Sport Gossip

Pop News

Showbiz
Lifestyle
Fashion
Shëndeti
Dieta
Receta gatimi

Programe

Big Brother VIP
Për'puthen
Shqipëria LIVE
Fiks Fare
Video
Të gjitha programet
Guida TV

Top Channel

Rreth Top Channel
Kontakt
Bileta – Portokalli
Puno në Top Channel
Privacy Policy & Terms of Use
Aksesueshmëria

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.